



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Prizren, 27.06.2016

**Këshilli për Trashëgimi Kulturore
i Qendrës Historike të Prizrenit**

REKOMANDIM


Investitori, **Dokufest**, me seli në rrugën, "Marin Barleti", me numrin e lëndës: 04-353-79000, me të cilën ka kërkuar prej Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor leje për vendosjen e kinos së përkohshme mbi lumin Lumbardh, shfrytëzimin e hapësirës publike tek "Sheshi i Dëshmorëve", vendosjen e 10 tavolinave në hapësirën para Shtëpisë së Kulturës, vendosjen e dyqanit të përkohshëm para Pro Credit Bankës, vendosjen e shtandeve në afërsi të Dokufestit, shfrytëzimin e hapësirave në të dy anët e lumit të ura e Arastës, shfrytëzimin e hapësirës publike tek Kompleksi i Lidhjes së Prizrenit, shfrytëzimin e një pjese të parkut "Andrra", shfrytëzimin e hapësirës të qafa e Kishës, vendosjen e tavolinave transmetuese, vendosjen e instalacionit të përkohshme në të dy anët e Urës së Gurit, vendosjen e instalacionit artistik mbi krojin e "Shatërvanit" (tek shtylla e ndricimit).

Këshilli pas shqyrtimit të lëndës rekomandon që t'i jepet pëlqimi për pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 14, në përjashtim të pikës së 13, që është vendosja e instalacionit artistik të përkohshme mbi Urën e Gurit. Për shkak të mungesës së planit/projektit të detajuar të instalacionit, këshilli nuk mund të merr vendim në lidhje me këtë kërkesë. Dhe rekomandimi i këshillit për pikën 9 (shfrytëzimi i Muzeut të Shehzadës) është, shfrytëzuesi të ketë kujdes të shtuar gjatë shfrytëzimit të Muzeut, në mënyrë që të mos dëmtohet Muzeu.

Anëtarët e Këshillit që ishin prezent;

1. Arbnor Morina /Anëtar / Kryetar
2. Igballka Rama /Anëtare / Nënkryetare
3. Artnet Haskuka /Anëtare
4. Svetlan hadjic /Anetare
5. Orhan Bislimaj / Anëtar
6. Faridin Shala / Anëtar

KTK, Pizren


Arbnor Morina, Kryetar.